



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 130/3 Prot.

Tiranë, më 18. 02. 2019

V E N D I M

Nr. 25, Datë 18. 02. 2019

Mbështetur në nenin 32/1/a të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 7 rregj., datë 24.01.2019, e A. K. kundër Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Qarku Fier (në vijim DRM Fier), në të cilën pretendohet për diskriminim *pa përcaktuar një shkak*.

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se ka qënë punonjëse e Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, Qarku Fier, për një periudhë prej rreth 4 (katër) vite dhe ka mbajtur pozicionin e Specialistes për Lejet Mjedisore dhe VNM-t. Gjatë periudhës Nëntor-Dhjetor 2018, Drejtuesi i Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Fier, në kundërshtim dhe në shkelje të procedurave të parashikuara në Ligjin “Për nëpunësin civil” dhe aktet nënligjore të tij, ka vijuar procedurat për largimin e ankuses nga puna. Gjithashtu, pretendohet se për shkeljet e konstatuara në disa dosje të trajtuara nga ana e ankuses së bashku me punonjës të tjerë, Drejtuesit e DRM Fier nuk kanë ngarkuar asnjë nga punonjësit e tjerë me përgjegjësi, duke trajtuar kështu A. K. në mënyrë të pabarabartë dhe diskriminuese. Në vijim të ankimit A. K. sqaron se, Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë inspektimeve të kryera në DRM Fier ka konstatuar shkelje në vlerësimin e dosjeve nga ana e disa specialistëve të tjerë, por ndaj tyre nuk është marrë asnjë masë. Sipas ankuses, edhe pse ndaj saj nuk është marrë asnjë masë disiplinore më parë, është bërë largimi nga puna i saj.

Subjekti ankues në përfundim, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

Pas shqyrtimit paraprak të saj, u konstatua se ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna prej subjektit ankues, në lidhje me shkakun e pretenduar dhe lidhjes shkakësore për trajtimin më pak të favorshëm.

- Për këtë arsye, me anë të shkresës Nr. 130/1 prot., datë 31.01.2019, Komisioneri i kërkoi ankueses të paraqesë shpjegime lidhur me shkakun e pretenduar (nuk kishte përcaktuar një shkak) dhe shpjegime të trajtimit të pabarabartë në raport me punonjësit e tjerë për shkakun e pretenduar.
- Me shkresën¹ datë 21.01.2019, subjekti ankues ka informuar ndër të tjera se pretendimet e saj i mbështet në:
 - *Mohimin e së drejtës për tu njohur me faktet për të cilat është marrë vendimi i largimit nga puna.*
 - *Krahasuar me punonjës të tjerë, për vendime kolektive (ku bëjnë pjesë kolegët e saj dhe drejtuesi i DRM-së), është penalizuar vetëm ankuesja.*
 - *Nga ana e drejtuesve të DRM-së Fier, nuk është marrë parasysh ankimi i bërë nga ankuesja lidhur me shkeljet e konstatuara në dosjet e trajtuara prej saj (dhe kolegëve).*

Në përfundim të shkresës së sipërcituar A. K., nuk vuri në dispozicion të KMD-së asnjë argument apo provë lidhur me shkakun e diskriminimit të pretenduar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

¹ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 130/2, datë 05.02.2019

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur. Ankuesja në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, lidhur me shkakun e diskriminimit.

Neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh. Në rastin konkret, ankuesja duhet të identifikojë një cilësi apo karakteristikë personale për të cilën pretendon se është trajtuar në mënyrë të pafavorshme.

Nga ana e ankueses është paraqitur informacion lidhur me problematikën që ka me drejtorin e DRM-së Fier, por nuk ka paraqitur fakte dhe prova apo shpjegime për të provuar shkakun e diskriminimit të pretenduar dhe për të provuar se trajtimi i pabarabartë i saj është bërë për shkak të cilësive të veçanta që ajo ka.

Për sa më sipër, Komisioneri vëren se, A. K. mund të jetë vënë përpara veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme të Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, Qarku Fier, por në bazë të rrethanave të shpjeguara prej saj, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “...ankesa nuk pranohet nëse nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetimi”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së shtetasës A. K., për shkak se nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Pa shkak)

(Fusha: Punësim)